REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 13/2019 (JR) **Vendim nr. 5 (JR)**
Datë 27.02.2019 **Datë 13.03.2020**

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga:

Sokol	**Çomo**	**Kryesues**
Ina	**Rama**	**Relatore**
Ardian	**Hajdari**	**Anëtar**
Natasha	**Mulaj**	**Anëtare**
Rezarta	**Schuetz**	**Anëtare**

mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 13.03.2020, ditën e premte, në orën 15.30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me sekretare gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik, i përfaqësuar nga Z. Darjel Sina.

OBJEKT: Shqyrtimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 90, datë 20.12.2018, për subjektin e rivlerësimit Adnand Kosova, me funksionin prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b pika 5 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Neni C pika 2, neni F pika 2 të Aneksit të Kushtetutës si dhe neni 63 i ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

TRUPI GJYKUES I KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"(në vijim ligji nr. 84/2016), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e Komisionerit Publik, i cili kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit nr. 90 datë 20.12.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin e subjektit të rivlerësimit Adnand Kosova nga detyra, pretendimet e subjektit të rivlerësimit i cili kërkoi përfundimisht lënien në fuqi të vendimit nr. 90 datë 20.12.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dëgjoi gjyqtaren relatore Ina Rama si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN NË MËNYRË TË PËRMBLEDHUR SE:

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin nr. 90 datë 20.12.2018 ka vendosur: "*Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Adnand Kosova, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Prokurorisë së Përgjithshme".*

2. Komisioneri Publik Darjel Sina me shkresën nr. 77/6 prot., datë 13.02.2019 i ka përcjell Komisionit ankimin e tij kundër vendimit të nr. 90 datë 20.12.2018 i cili konfirmoi në detyrë subjektin e rivlerësimit Adnand Kosova. Ankimi i Komisionerit Publik është bërë duke konsideruar rekomandimin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim ONM) i cili me shkresën nr. 92/2 prot., datë 01.02.2019, i ka dërguar Komisionerit Publik. Pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim "Kolegji"), kjo çështje është regjistruar në Regjistrin e Çështjeve të Juridiksionit të Rivlerësimit me nr. 13/2019(JR) datë 27.02.2019.

3. Pas regjistrimit të çështjes në Kolegj, më datë 17.12.2019 është depozituar një denoncim i sjellë nga Albiona Papajani me funksionin prokurore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat, i cili ishte përcjellë njëkohësisht prej saj edhe Komisionerit Publik e ONM-së. Në këtë denoncim, denoncuesja pretendon për ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit të cilat kanë lidhje familjare të afërt me të, dhe si të tillë nuk janë deklaruar prej tij në formularin për kontrollin e figurës sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016. Ky denoncim me vendim të ndërmjetëm të trupit gjykues të Kolegjit iu nënshtrua hetimit.
Për këtë çështje, Prokuroria e Përgjithshme me anë të shkresës së saj nr. 278/26 datë 19.02.2020 i ka përcjellë Kolegjit përgjigjet e të gjitha prokurorive pranë gjykatave të të gjitha rretheve gjyqësore me juridiksion të përgjithshëm, si dhe përgjigjen nr.1197/1prot datë 13.02.2020 të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Po ashtu, edhe subjekti dha shpjegimet dhe parashtroi pretendimet e tij mbi këtë denoncim.

4. Komisionieri Publik në konkluzionet e tij, pas kryerjes së hetimeve nga Kolegji mbi denoncimin e marrë, si dhe pas dëgjimit të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit në seancat gjyqësore publike mbi ankimin e Komisionerit lidhur me kriterin e kontrollit të pasurisë, theksoi se :

I. Subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë me dokumentacion justifikues ligjor arkëtimin e shumës prej 1.500.000 lekësh që ka shërbye si burim për blerjen e apartamentit prej 98 m^2 në rrugën "Muhamet Gjollesha", në Tiranë, shumë e cila nuk rezulton të jetë përcaktuar as në kontratën e shitblerjes së një apartamenti në Korçë në vitin 2002. Si rrjedhim, subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë bindshëm në përputhje me nenin D pika 3 të Aneksit të Kushtetutës burimin e të ardhurave për krijimin e kësaj pasurie.

5. Në përgjigje të shkakut të ankimit të Komisionarit Publik, subjekti i rivlerësimit Adnand Kosova, ka parashtruar me pretendimet përfundimtare sa vijon :

I. Shkaku i ankimit i parashtruar nga Komisionari Publik nuk qëndron, pasi ai gjate hetimit administrativ të kryer në Komision si dhe me shpjegimet e dhëna gjatë gjykimit në Kolegj, ka mundur të shpjegojë bindshëm, marrjen në shkurt të vitit 1998 të shumës prej 1 500 000 lekësh në formën e kaparit, e cila rridhte nga një marrëdhënie ligjore e parashikuar nga Kodi Civil në funksion të shitjes së apartamentit të tij në Korçë.

6. Kolegji pasi analizoi shkaqet e ankimit të parashtruara në konkluzionet e Komisionerit Publik, prapësimet e subjektit të rivlerësimit, shqyrtoi të gjitha provat e marra gjatë hetimit administrativ në Komision dhe ato të marra gjatë shqyrtimit gjyqësor të zhvilluar në Kolegj, konkludon sa më poshtë:

Subjekti i rivlerësimit si gjatë hetimit administrativ të kryer në Komision ashtu edhe gjatë gjykimit në Kolegj, rezulton se nuk arriti të justifikojë me dokumentacion marrjen e kaparit në kuptim të nenit D pika 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 33 pika 5 germa "b", të ligjit nr.84/2016, shumë e cila sipas subjektit të rivlerësimit është përdorur prej tij për pagimin e këstit të parë për blerjen e apartamentit prej 98 m^2 në rrugën "Muhamet Gjollesha", në Tiranë.

7. Në përfundim, mbështetur në konkluzionet e mësipërme Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve financiarë dhe nuk arrin të justifikojë burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë së deklaruar prej tij, duke kryer deklarim të pamjaftueshëm të parashikuar në nenin D pika 3 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 61 pika 3 dhe nenin 33 pika 5 germa "b" të ligjit nr. 84/2016 .

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues bazuar në nenin 66, pika 1, germa "b" të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 90, datë 20.12.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Adnand Kosova.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 13.03.2020

ANËTARE	**ANËTARE**	**ANËTAR**
Natasha MULAJ	**Rezarta SCHUETZ**	**Ardian HAJDARI**
nënshkrimi	*nënshkrimi*	*nënshkrimi*

RELATORE	**KRYESUES**
Ina RAMA	**Sokol ÇOMO**
nënshkrimi - kundër	*nënshkrimi - kundër*